# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-453693**
VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | “Më tha se i duheshin për ilaçe, i dhashë 30 mijë lekë dhe u zhduk” |
| ADRESA | `https://joq-albania.com/artikull/1392383.html` |
| BURIMI | joq-albania.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 17 shtator 2026, 23:05:50 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 17 shtator 2026, 22:58:00 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me metodën **text_date**. Dritarja: 17 shtator 2026, 22:57:00 UTC → 17 shtator 2026, 22:59:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `9f34c35fd73d7ab5d42dc1d5bd0b9cebccb85796f9b6abcb99276ca9306a8a82` |
| TEKSTI | `9a86a00b093bc9d056e8ae4a837d0df749ad439263f45ff5e4821f8e54215d6a` |
| PAMJA | `380fc43e514da506c878bdbd2b9f7a5759743a239a2b53e2f6322790a633f885` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `a0054f033f241053ec8f7f29329290c2f0fd4557a8a40886f0f7891ba90ee9c4` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `dd1267ef168833862ec5458d6ebd651bdeec8985e991f38f39b7c2b63c1524a7` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/a0054f033f241053ec8f7f29329290c2f0fd4557a8a40886f0f7891ba90ee9c4`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# "Më tha se i duheshin për ilaçe, i dhashë 30 mijë lekë dhe u zhduk"

Shkruar nga: V Gashi | Publikuar më: 18.09.2026, 00:58

Share Share



Një taksist nga Elbasani ka kontaktuar redaksinë e JOQ Albania për të denoncuar një rast që, sipas tij, ka ndodhur gjatë punës dhe që e ka bërë të dyshojë se është mashtruar.

Sipas denoncuesit, një i ri e kishte telefonuar për ta transportuar drejt një farmacie. Pasi mbërritën, i riu i ka kërkuar 30 mijë lekë të vjetra, duke i thënë se nuk i mjaftonin paratë për të blerë ilaçet që i nevojiteshin.

Duke besuar te arsyeja e paraqitur, ai thotë se vendosi t'ia jepte shumën. Por, sipas tij, i riu u largua dhe nuk u kthye më. Denoncuesi pretendon gjithashtu se telefoni i të riut është fikur dhe nuk ka mundur ta kontaktojë më.

Në redaksi janë dërguar edhe pamje nga kamera e mjetit, ku shihet i riu teksa i afrohet automjetit, pak para momentit kur, sipas denoncuesit, i ka kërkuar paratë. Momenti i dhënies së shumës nuk është filmuar, ndaj kjo pjesë mbetet në dëshminë e tij.

Taksisti thotë se nuk ka bërë ende kallëzim në polici, por i ka bërë thirrje të riut që t'i kthejë paratë, duke paralajmëruar se në të kundërt do t'i drejtohet autoriteteve.

"Dua të m'i sjellë lekët pa shkuar të bëj kallëzim në polici", shprehet ai, duke kërkuar që personi në pamje të identifikohet dhe rasti të sqarohet.

Nëse pretendimet e denoncuesit rezultojnë të sakta, rasti ngre shqetësim edhe për mënyrën se si mund të shfrytëzohet gatishmëria e dikujt për të ndihmuar një person që pretendon se ndodhet në vështirësi. Për çdo përgjegjësi të mundshme, mbetet e nevojshme verifikimi i rastit nga autoritetet.



Më të Lexuarat

Aleanca për Media Etike
ARTIKULL JOETIK?

View this post on Instagram

A post shared by JOQ Albania (@joqalbania)

**FACT CHECK:** Synimi i JOQ Albania është t'i paraqesë lajmet në mënyrë të saktë dhe të drejtë. Nëse ju shikoni diçka që nuk shkon, jeni të lutur të na e raportoni këtu.

JOQ Sondazh
KLIKO PËR TË VOTUAR

## TË NGJASHME

## Më të fundit



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.